



Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

001 Numër: 72/2026

Data:20.05.2026



Komuna e Istog

Opština Istok

Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

Për: Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës-Istog

Në bazë të nenit 43 neni 45 dhe neni 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe nenit 48.3 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, neni 5 i Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

T H Ë R R A S

Mbledhjen e 6-të të rregullt të Legjislacionit të VIII-të të Kuvendit të Komunës. Mbledhja do të mbahet me: **29.05.2026, e Premte**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati III, duke filluar me punë në ora 10:00.

R E N D D I T E:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Njoftim me Qarkoren Buxhetore nr.1 të Ministrisë së Financave për kufijtë preliminar të përgatitjes së Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Plotësim - Ndryshimit të Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha.
5. Bartja e mjeteve të pashpenzuara buxhetore të hyrave të bartura nga viti fiskal 2025, dhe të hyrat e tejkaluara në vitin 2026.
6. Projektet e reja kapitale në bashkëfinancim me komunitetin për vitin fiskal 2026-2027.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Plotësim - Ndryshimit të Rregullores për Orarin e Punës për Subjektet Afariste, Hoteliere, Prodhuese, Zejtare dhe Shërbyese në Komunën e Istogut.
8. Miratimi i planit të punës së KKS-së për vitin 2026.



Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova

Enver Rugova

Vërejtje :

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në mbledhje, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 paragrafi 39.8 të LVL.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e pestë të Legjislacionit të VIII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 30.04.2026, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|--------------------------------|----------------------------|
| 1. Enver Rugova, LDK; | |
| 2. Zenel Shatri, LDK; | |
| 3. Arianit Selmanaj, LDK; | |
| 4. Faruk Kabashi, LDK; | |
| 5. Ruzhdi Metaj, LDK; | |
| 6. Arta Balaj, LDK; | |
| 7. Liridona Lajqi Avdiaj, LDK; | |
| 8. Ajshe Imeraj, LDK; | |
| 9. Abetare Sutaj Arifaj, LDK; | |
| 10. Valbona Demaj, LDK; | |
| 11. Faik Alushaj, LDK; | |
| 12. Bedri Haxhiu, LDK; | |
| | 13. Ali Nimanaj, PDK; |
| | 14. Astrit Hajrizaj, PDK; |
| | 15. Kaltrina Arifaj, PDK; |
| | 16. Arben Kabashi, PDK; |
| | 17. Nexhmedin Balaj, PDK; |
| | 18. Astrit Bujupaj, VV; |
| | 19. Niman Beqiraj, VV; |
| | 20. Floriana Maxharra, VV; |
| | 21. Ukë Blakaj, AAK; |
| | 22. Lulzim Shoshi, L.SH; |
| | 23. Valmir Rama, IRDK; |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Nënkryetari i Komunës z. Genc Ademaj, Drejtorë të drejtorive, Zyrtar administrativ, përfaqësues të OSBE-së, mediat (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje)

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar
[Link](#)).

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje, dhe i njofton me rendin e ditës për këtë mbledhje.

Konstaton së 23 anëtarë të kuvendit të Komunës janë prezentë dhe mundë të fillojmë me mbledhjen, vazhdon:

Procesverbali

R e n d d i t e

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,
3. Shqyrtimi i raportit financiar për tremujorin e parë (Janar-Mars) të vitit 2026,
4. Themelimi i Komisionit për formimin e këshillave të fshatrave,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për rishqyrtimin e Vendimit 001 Nr.45/2026 për miratimin e Listës së përgjithshme dhe Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës së Istogut që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026.

Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova – pyet nëse ka dikush diçka rreth rendit të ditës.

Pasi që nuk ka po vazhdojmë.

Piken e parë e konstatuam në fillim prezencën e anëtarëve të kuvendit .

Niman Beqiraj, LVV – përshëndet të gjithë të pranishmit, propozoj për rend dite piken Pyetje dhe përgjigje apo të ndryshme si do që ta quani kjo është si arsyetim që ti jepet mundësia anëtarëve të kuvendit të cilët përfaqësojnë dikë ose lagjet ose fshatrat, qytetaret në përgjithësi ti shprehin të gjitha ato kërkesa ose shqetësimet e qytetarit brenda kuvendit komunal këtu në Istog. Prandaj mendoj që është pjese e demokracisë. Secila komunë në nivel të Kosovës e ka këtë pikë prandaj kërkojmë edhe këtu në Istog mos të kufizohet fjala e anëtarit të kuvendit të komunës dhe të votohet.

Astrit Hajrizaj, PDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, kam një shqetësim në materialin e marrë përmes emilit ku është dashur të na bashkëngjitet edhe vendimi i MAPL-së për vlerësimin e pikave të miratuara dhe vlerësimin e mbledhjes urgjente, mbledhjeve të kaluara ne duhet të na ofrohet ky dokument.

Kryesuesi i Kuvendit – dje kam pranuar dy shkresa nga MAPL-ja, që keni bërë ankesa Astriti dhe Nimani, tani do ti keni kopje sepse dje 3 ora pasdite kemi marr përgjigjet në shkresa shkruan se gjithçka është në rregull.

Astrit Hajrizaj, PDK – nëse gjithçka ka ardh në rregull ne e pranojmë dokumentin dhe e shikojmë dhe është me rendësi ta kemi të bashkëngjitur jo vetëm pjesën e Seances që kemi kërkuar ne, por edhe vendimit se cilat janë arsyet e rishqyrtimit të listës së Përgjithshme dhe te veçante të pronave për vitin 2026.

Kaltrina Arifaj, PDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, a lejohet që brenda një seance me u votu për një pike të rendit të ditës dy herë, ku edhe disa nga anëtarët e juaj e kanë votuar. Se çka ka ndodhur në mbledhjen që ka vazhduar dhe këta kanë votuar prape kundër, dua të di se a është e lejuar që e njëjta pike e rendit të ditës në këtë rast pika të ndryshme të votohet dy here, dhe në seancën tjetër me e hekë prape.

Kryesuesi i Kuvendit – sqaron, rreth pyetjeve.

Kaltrina Arifaj, PDK – dua të ju pyes ju dhe Kryetarin e Nënkyetarin dhe tjerët si ndiheni ju se jemi komuna e vetme që nuk e kemi mundësinë me diskutuar në asamblenë komunale e cila mbahet një herë në muaj. Dhe nuk e kemi mundësinë me diskutuar për kërkesat e qytetarëve.

Dua ta bëjë një kërkesë për udhëkryqin që ndodhet në rrugën “Fehmi Agani” ku ditët e fundit kanë ndodhur disa aksidente dhe po paraqet rrezik për qytetarët, ku janë lënduar edhe disa policë. Po lëndohen qytetarët fizikisht por edhe financiarisht çka ne duhet me ndërmarr masa me forcë sinjalizimit ose me ndërtuar një rreth.

Kryesuesi i Kuvendit – sqaron, rreth pyetjeve.

Nënkyetari i komunës. Z. Genc Ademaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, sqaron rreth pyetjeve.

Niman Beqiraj, LVV – nënkryetari e laburoj pse duhet me qenë kundër ose për pikës të cilën e propozova me herët mirë po ka raste kur kam bere pyetje vitin e kaluar me shkrim është edhe dëshmia që nuk me u ka kthyer përgjigja hiq. Nëse edhe me shkrim nuk ka përgjigje atëherë cila është detyra e anëtarit të kuvendit të komunës, s’po e kuptoj nëse nuk i ki numrat po i bjen se nuk duhet me pas zë hiq kjo i bjenë. Është e pa drejt ti merret fjala ose e drejta për me fol ose me shpreh ata çka e përfaqëson secilin prej kuvendit çoftë nga pozita apo nga opozita kështu jeni duke shkuar drejt komunizmit edhe nuk ndodh kjo far pune se nuk ndodhë.

Arben Kabashi, PDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, në mbledhjen e KPF-së ke thënë që e bien materialin këta tani që e kërkoj Astriti është vetëm kërkesa që r kanë bere në MAPL rreth mbledhjes urgjente, por jo materialin për piken e 5te. Ke thënë se e bie materialin dhe duhet me e pru sepse është vendim i MAPL-së, konfirmimin .

Pika të ndryshme, kjo pikë duhet te jetë ku nuk ka demokraci nuk është ajo pikë

Valmir Rama, IRDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, në email e kemi konfirmimin nga MAPL, kjo imail na ka ardhur.

Kryesuesi i Kuvendit – sqaron, materiali ju dërgohet te gjithëve i njëjti.

Astrit Hajrizaj, PDK – në imelin tim nuk figuron vendimi për rishqyrtim nuk ka ardhur. Nuk e di se për çfarë arsye dikujt i pengon pika të ndryshme, ekziston nga e kaluara edhe ju keni qenë pjesë edhe disa nga ne pjesë e ekzekutivit, kur në një pikë te rendit të ditës shumë here kemi dal nga pika e rendit te ditës kemi diskutuar tjetër temë. Momentin që e kemi piken të ndryshme ne vazhdojmë me procedu me pikat që janë me rend dite kur është ajo pik diskutimet i bëjmë aty. Nuk besoj është e arsyeshme me i ik debatit ne qytetarët na kanë besuar që ti përfaqësojmë këtu interesat e tyre dhe kërkesat e tyre. Pika të ndryshme e lehtëson punën e kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit – a ka edhe dikush diçka?

Hedh në votim propozimin e z. Niman Beqiraj te ndryshme

Kush është që kjo pikë të hy në rend dite?
9 vota për, 12 kundër dhe 2 abstenime
Nuk hynë në rend dite pika të ndryshme.
Prezent në sallë 23 anëtar të Kuvendit.

Hedh në miratim Rendin e ditës
16 vota për, 3 kundër dhe 2 abstenime
Miratohet rend i ditës me shumicë votash.
Prezent në mbledhje 22 anëtar te kuvendit.
Vazhdojmë me pikat e rendit të ditës.

Pika 1

Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova - Arsytimi i mungesave në mbledhje, në mbledhje mungon me arsye Lirie Demiraj Sadikaj, Fjolla Ukaj, Haki Podrimaj, Hajrush Shoshi.

Pika 2

Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova - Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara e datës 30.03.2026, mbledhja e rregullt, a ka dikush diçka ?
Hedhe në votim
Me 13 vota për dhe 8 vota abstenim
Miratohet me shumicë votash
21 anëtar prezent në sallë.

Vazhdojmë me procesverbalin e mbledhjes Urgjente te datës 30.03.2026. a ka dikush diçka,
Hedh në votim?
Me 13 vota për dhe 8 vota abstenim
Miratohet me shumicë votash
21 anëtar prezent në sallë.

Pika 3

Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova – vazhdojmë me piken e tretë te rendit te ditës. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e parë (Janar - Mars) të vitit 2026, a ka dikush diçka ?

Qendrim Ibrahimaj, ZKF - përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Raportit financiar për tre mujorin e parë (Janar - Mars) të vitit 2026.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Enver Rugova – hapë diskutimin a ka dikush diçka?

Kaltrina Arifaj, PDK – në raport kemi vërejtje për transparencë për efikasitet të shpenzimeve edhe për realizim të te hyrave dhe prioriteteve buxhetore. Dihet që vonë janë emëruar drejtorit edhe prej 9 milion e 100mije te alokuara dhe janë shpenzuar veç 3.5 milionë pra veç 38.72% ku dominojnë pagat dhe mëditjet ku 84% te shpenzimeve te këtij 3.5 milionëshi dominojn vetëm paga dhe mëditje këta tre muajt as nuk jeni merr me zhvillim ekonomik as me subvencione as me mbështetje të klubeve sportive.

Në muajt në vijim a keni planifikuar ndonjë gjë dhe si planifikoni me i rrit të hyrat vetanake të cilat i kemi vetëm 1% .

E tha edhe zyrtari që kemi varësi prej grandeve 97% si komunë çka planifikojmë në të ardhmen që me i rrit të hyrat vetanake.

Te raporti i shpenzimeve, në tre mujorin e parë në krahasimin e vitit 2025 kemi 48.96% me shumë shpenzime në administratë, sqarim çka është shtesa e performancesë shtesat tjera janë te cekura por këtu janë harxhuar me shumë se gjysmë milioni çka është sepse vitet tjera nuk është. Shërbimet e ndryshme shëndetësorë ku janë shpenzuar, edhe shërbimet teknike një përqindje shumë të madhe në krahasim me vitin e kaluar ku kanë shkuar këto shërbime, drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje a është keq menaxhim i vitit kaluar apo për çka janë nda këto 14 mije e 703 euro. Mirëmbajtja rrugore është 119% me shumë se tre mujorin e vitit kaluar.

Te planifikimi dhe shpenzimi i projekteve kapitale, te raporti i numrit të punëtoreve kemi numër me te madh të punëtoreve në disa drejtori p.sh në Arsim janë 2 punëtor me shumë në çerdhe edhe 1 punëtor me shume në arsimin e mesëm, edhe 2 me shumë në Kuvendin komunal.

Nënkryetari i Komunës, z. Genc Adenaj – këto raporte janë me sistem frebalanc për të gjitha organet shtetërorë, nëse keni vërejtje drejtojuni Ministrisë Financave. Sqaron rreth të gjitha pyetjeve të parashtruara.

Faruk Kabashi, LDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, vendet e lira të hapura të punës a janë në proces apo mbesin kështu dhe nuk mundemi me i plotësuar.

Nënkryetari i Komunës, z. Genc Adenaj – sqaron rrethe pyetëse.

Valmir Rama, IRDK – dua ti jap disa propozime sepse në kete tre mujorsh nuk është prek pjesa e komiteteve, përpos në Llukafc të Begut shumë pak është punuar, vetëm në Llukafc të Begut lagja e banuar me komitet tjerat vende nuk ka investime kapitale që e prekin drejt për drejt jetën e komunitetit edhe pse mandatin e kaluar bashkarish kemi bere shumë investime në shumë lagje ku janë të banuara me komunitete edhe pse komunitetet nuk vine në dëgjime publike për me i shprehë qëndrimet e tyre a me i propozuar investimet kapitale janë disa rrugë si Oprashka, Banja. Lagja Qakollaj në Serbobran rruga Dituria, Istog i Poshtëm lagja Fazliaj. Ndriçimi publik në Lagjen Verrini, rruga e varrezave në Veriç dhe rruga Podguri, e shume tjera që besoj që bashkërisht me nënkryetarin kemi me diskutuar dhe me u mundu që disa projekte me i shty në investime kapitale që do të jenë në vijim.

Nënkryetari i Komunës, z. Genc Adenaj – sqaron rrethe pyetëse.

Arben Kabashi, PDK – nuk jemi duke folur për kornizë afatmesme jemi duke folur për një tre mujorsh sa kemi pas te hyra dikun 1% ndoshta mbledhja e mungesës te tatimit në pronë që me krahasu me viti e kaluar kemi qenë shumë përpara p.sh mos të them një muaj ose një muaj e gjysme përpara qe i ka rrit edhe të hyrat në këtë tre mujorsh. Sipas këtij raporti ne jemi varur vetëm nga Qeveria për shpenzime. Po e shikojm tre mujorin e dyte.

Nënkryetari i Komunës, z. Genc Adenaj – pjesa e alokimit dhe realizimit dallojnë sqaron.

Niman Beqiraj, LVV – te pagat dhe mëditjet janë shpenzuar 100% mirë po gjatë këtij tre mujori tash 13 drejtorë që janë këtu ne nuk i kemi pasur nënkryetarin me gjasë, dua te di ku janë shpenzuar këto paga 100% .

Nënkryetari i Komunës, z. Genc Adenaj – 100% është rezultat i pagës së 13 .

Kryesuesi i Kuvendit - Vazhdojmë me piken tjetër të rendit të ditës
Prezent në mbledhje 22 anëtar te Kuvendit te Komunës

Pika 4

Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova - Themelimi i Komisionit për formimin e këshillave të fshatrave? Kjo pike është e planifikuar me rend dite, përzgjedhja e këtij komisioni behet në bazë të rregullores, sqaron procedurat biiu d. A ka dikush diçka?

Arta Balaj, LDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, nga LDK për komision propozojmë Abetare Sutaj Arifaj.

Faruk Kabashi, LDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, nga LDK për komision propozojmë Arianit Selmanaj.

Astrit Hajrizaj, PDK – në emër të PDK-së ne do ta përcjellim emrin gjate ditës.

Floriana Maxharraj, LVV - përshëndet të gjithë të pranishmit, nga LVV për komision propozojmë Astrit Bujupaj.

Lulzim Shoshi, i pavarur - përshëndet të gjithë të pranishmit, është mirë se për ne që jemi te ri në këtë mandat, pasi që Rregullorja është miratuar para dy vitesh. Çka ka ndodhur Arben para dy vitesh qe nuk e ke krye punën a s'të kanë lan këta apo cili ka qenë problemi.

Është mirë për transparencë dhe qytetarët se çka jemi duke votuar kush janë këta kryetar të këshillave cila është kompetenca e tyre, kam dëgjuar se këta Kryetar te këshillave do te kenë zyre do te paguhen mirë do kenë një far autoriteti.

Para se me e qit në votim duhet që se pari me na sqaruar saktë çka jemi duke votuar, çka po formojmë dhe cila është detyra e këtyre njerëzve.

Arben Kabashi, PDK - personi kryesor që nuk ka dashtë me e realizuar implementuar Rregulloren ka qenë Kryetari i Komunës ska dashtë me i zgjedh këshillat lokal, tash te njëjtën çështje e kam ngritur për me e zgjedh këtë komision qe me na dhen te drejtën me e zbatuar Rregulloren me i zgjedh këshillat lokal. E merr Rregulloren e lexon pak i ki 5 a 6 fleta edhe gjithçka në rregull.

Lulzim Shoshi, i pavarur – sa kam mundur ta përcjell kuvendin sa ke qenë koalicion me Ilir Feratin nuk ki pas najë ankese, keni qenë të harmonizuar mirë keni bashkëqeveris, keni nejtë urte s’kini pas ankesa, është e rend tani pasi që je dal në opozitë me ja lanë fajin kryetarit ti nuk e ki kryer punën.

Arben Kabashi, PDK - nuk po bëj politik sepse nuk është koha. Rregullorja është punuar me kreks nga unë u formu komisioni, komisioni formohet direkt nga kryetari i komunës për zatimin e rregullores jo vetëm të kësaj potë te gjitha Rregulloreve që miratohen në kuvend është detyre e kryetarit të komunës me i zbatuar. Kur done mundet me e zbatuar kur s’don nuk e zbaton, lype përgjegjësini tek aji.

Po besoj që është një shembull i mirë i koalicionit prandaj jemi dal edhe dy patrit e para. Ne kohen tënd jemi kanë e katërta tani jemi partia e dytë në komunën e Istogut.

Niman Beqiraj, LVV – në një pjese te fjalimit te kolegut Lulzim Shoshi po pajtona, nuk po them me krejt vetëm një pjesë, meqë rasti duhet me pas me shumë të dhëna unë e kam votuar Rregulloren dhe e di çka do me thëne mirë po është e vërtet që ka plot që janë për here te pare e ndoshta nuk e kanë pasur mundësin me e lexuar sepse kjo veç ka kaluar dhe as një here nuk ka hyr në shqyrtim disa nga arsyet të cilat i tregoj edhe kolegu Arben Kabashi. Kërkoj për hir të qytetarëve dhe kolegëve të ri që të del drejtori i ri le te na sqaron të gjitha këto.

Nënkryetari i Komunës z. Genc Ademaj – Prezanton dhe sqaron Rregullores dhe formimin e komisionit për themelimin e Këshillave të fshatrave.

Niman Beqiraj, LVV – e kam parë në dy komuna që ka qenë në diskutim kjo rregullore rreth pagesës problematik e ngjajshëme me komunat e tjera mirë po ata e kanë bere një zgjidhje ndoshta kish qenë mirë që gjatë kësaj kohe deri sa te formohet komisioni me shiku, besoj që ka zgjidhje me dashtë. Sa i përket këtij këshilli të fshatrave mendoj që është shumë e rëndësishme për shkak se kemi përfaqësues te fshatrave që janë të vet thirrur ose vet shpallur kryetar që marrin vendime në emër të fshatit ose bëjnë kërkesa në emër të fshatit ndodh që nuk është përfaqësimi me i mirë i fshatit, është mirë me e pas fshati një kryetar që e ka zgjedhur vet dhe se e mban në përgjegjësi. Çështja e pagesës shpesh e kanë bere edhe vet vullnetarisht por nëse është edhe një mëditje nuk është najë far shpenzimi i madhe.

Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova – pagesa behet nga madhrrat dhe shërbimet e tha edhe nënkryetari ne i kemi vetëm 20 mijë euro në kuvend dhe komplet këtë buxhet duhet me e nda për këshilla te fshatrave sepse këtu ka shpenzime edhe tjera nuk është vetëm mëditja. Pra duhet me e nda një vi buxhetore të veçantë për këshilla të fshatrave.

Vazhdojmë me votim:

Hedh në votim,

Me 22 vota për dhe 1 kundër

Miratohet me shumicë votash Themelimi i Komisionit për formimin e këshillave të fshatrave.

Konstatohet prezencën e anëtareve të kuvendit 23 anëtarë prezent

Ukë Blakaj, AAK – përshëndet të gjithë të pranishmit, e kuptoj që politikisht edhe këshillat e fshatrave po zgjedhën në këtë formë mirë po e shohë që është një gabim sepse këshilli i fshatit apo kryetari i fshatit duhet të jetë apolitik dhe të organizohen ashti siç duhet, mos te behet politik se e di bazë të votave që janë këtu behet por mos te behet ajo. E shohë një gabim dhe për mua është e pa pranueshme dhe në të gjitha ato lagje apo fshatra te zgjidhen ata vet dhe me një komision nga kuvendit i komunës te aprovohet ajo, e jo të imponohet dikush nga LDK dikush nga PDK apo tjera parti për mu është një gabim.

Drejtori i Administratës, z Driton Alihajdaraj - përshëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e Rregullores për Organizimin dhe Bashkpunimin e Komunës me fshatra, Vendbanime dhe Lagje Urbane në Territorin e Komunës së Istogut. Dhe Funksionimin e Komisionit për përzgjedhjen e këshillave lokale.

Pika 5

Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova - Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për rishqyrtimin e Vendimit 001 Nr.45/2026 për miratimin e Listës së përgjithshme dhe Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës së Istogut që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026. Sqaron rreth kthimit nga MAPL.

Drejtor i Kadastrit z. Agon Dreshaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e rishqyrtimit të Vendimit 001 Nr.45/2026 për miratimin e Listës së përgjithshme dhe Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës së Istogut që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026

Astrit Hajrizaj, PDK – po ndërlidhem pak edhe me mbledhjen e kaluar kur ne në emër të grupit të PDK-së kemi kërkuar që kjo pikë të shtyhet pikërisht për datën e sotme në seancën e ardhshme këtu po del që kemi pasur të drejtë dhe që kemi pasur mundësi ka ekzistuar për deri sa vet kemi mundësi me diskutuar dhe me shqyrtuar listën e veçantë dhe të përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunave të Istogut na jep këtë mundësi. Kur flasim të arsyetimi nuk thotë që kemi bere ndonjë shkelje ligjore por që nuk është në përputhje me ligjin po nënkupton që nuk janë zbatuar dispozitat ligjore. Sa i përket debatit këto prona patjetër se duhet me pas interesin publik kam pasur fatin që në të kaluarën me u merr edhe vet me këtë çështje ku kam iniciuar dhe kam bere presion që këto prona me u vazhdu me u procedu dhe me u jep në shfrytëzim me qellim të

interesit publik dhe të rritjes së inkasimit të hyrave me dhenjen e shfrytëzimit të këtyre pronave. Këtu me intereson je detaj a janë të gjitha në harmoni me planin zhvillimor komunal dhe me hartat zonale. Sa i përket periudhës të cilën e kanë kërkuar që të specifikohet qëllimi i dhënies së ndonjë parcele është çështje që mundet me ndryshu në varsi me kërkesat e parashtruara dua ta di këtë çështje. Po ashtu mbetemi në të drejtën tonë që kemi kërkuar që të shtyhet dhe kemi këmbëngulur që afatet i fundit ka qenë 30 marsi. E dimi që ne bazë të ligjit afati është për publikim 30.12 me qëllim që vitin vijues të kemi mundësi që të procedojmë.

Kryesuesi i Kuvendit, Enver Rugova- nuk mund të pajtohem Astrit në aspektin e legjislaturës. Saktë e thotë 31 mars kur është vit zgjedhor, dhe ka qenë dita e fundit atëherë sepse kishte me qenë me lehtë për ekzekutivin që të kishte më shumë kohë, kisha qenë parimisht me ty por nuk e lejon ligji sepse kjo datë është e fundit 31 mars. Fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj, LVV- kam nevojë për disa sqarime, të rasti i arsytimit meqë nuk e kisha pas parë më herët, komuna po thotë obligohet që listen e pronave të paluajtshme që deri me 31 dhjetor me e sqaruar. Këtë besoj që komuna e ka bërë me kohë dhe nuk kishte pas nevojë me e rishqyrtuar dhe kishte kaluar në atë kohën kur ka qenë. Por me gjasë problemi duhet me qenë se në vitin zgjedhor 6 muajt e fundit me dhënë tokë por kjo nuk e arsyeton atë që brenda muajit 31 dhjetor të vitit paraprak me e propozuar listen e pronave që ke me i jep. E kam edhe një pyetje të rasti i kompanisë e cila ka pasur me investuar në Dubravë me pjesën e njësisë që është e evidentuar 708060200099/11 për kompaninë Pharmabel kësaj thuhet që i është dhënë për një vit toka por aty shkruan që brenda tetëmbëdhjetë muajve duhet me i kryer punimet, unë nuk e kuptoj si do me ja dhënë këto tokë dikujt tjetër, kush është ai që duhet të futet në garë meqenëse me lejen e juve është vendosur gurthemeli, ose të paktën është mirë me e parë një leje prej drejtorisë së Inspektionit se a ka të drejtë me e bërë një investim i cili përfshinë më shumë se dymbëdhjetë muaj që i është dhënë, si do me e trajtuar këtë rast sepse çdokush ka të drejtë të aplikoj për atë tokë, për atë po them është pak e dyshimtë kjo çështje për shkak se kjo edhe u bë në kohë të fushatës.

Nënkryetari i Komunës, z. Genc Ademaj- të pjesa e investitorit e ndjej për obligim që ta jap një sqarim. Por së pari të flas drejtori Agon Dreshaj pastaj unë.

Drejtor i Kadastrit, z. Agon Dreshaj- po filloj prej Astritit, ligji e precizon saktë që deri me 31 dhjetor publikohet lista e veçantë dhe e përgjithshme e pronave komunale, në rastet e viteve zgjedhore as nuk kërkon komuna, e as nuk precizohet në ligj por MAPL-ja automatikisht ministri merr vendim që të gjitha komunave ja u jep një afat shtesë prej tre muajsh deri me 31 mars që me e aprovuar këtë listë të veçantë në secilin rast në vitet zgjedhore, kështu ka qenë në

vitin 2022 nëse ju kujtohet me 31 mars e kemi votuar listen. Atë ditë nuk kemi pasur të drejtë ta shtyjme, kemi pas të drejtë ta heqim krejt ose me e lënë por jo me e shtyer sepse nuk ke të drejtë të dalësh jashtë 31 marsit. Tani që e ka kthyer MAPL-ja në rishqyrtim automatikisht ja jep komunës 30 ditë me e rishqyrtuar, tani e kemi një afat shtesë prej 30 ditësh jashta këtij prej tre muajsh. A janë në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal, pikërisht këto kolonat tjera që i kemi futur në pjesën e listës së veçantë të pronave, destinimin dhe qëllimin e këtyre parcelave është i nxjerrur prej Hartës Zonale të komunës së Istogut. Të percaktimi i periudhës kohore kjo ka qenë njëra prej vërejtjeve që i kam jep, që nuk mundet në listë me qenë precize një periudhë kohore, p.sh po supozojë për një parcelë 20 vite duam ta japim në shfrytëzim, e vjen investitori thotë unë dua të investoj këtu nëse ma jepni për 30 vite. Për këtë arsye nëse e keni pare në këtë plotësimin e ri është e cekur afatshkurtër dhe afatgjatë sepse është kategori ligjore. Niman po besoj që këtë sqarim që ja jepa Astritit, vlen edhe për ty që e pate të pa qartë. Lidhur me atë që kush futet në garë për parcelën që fole për rastin konkret të investimit, neni 11 i ligjit për Dhënie në Shfrytëzimin dhe Këmbimin e Pronës përcakton negociimin e ofertave direkt prej kryetarit, por në këto raste plotësohen disa kushte, dhe ka pasur raste të tilla në të kaluarën.

Nënkryetari i Komunës, z. Genc Ademaj- të ndërtimi i fabrikës për prodhimin e barnave, nuk po them fatkeqësisht por ka qëlluar në kohë të zgjedhjeve. Investitori është belg, dhe francez, kërkesa e tyre ka qenë që me pas pronën në shfrytëzim siç e potencove ti kryetarit të komunës i mohohet e drejta me dhënë pronë në shrytëzim afatgjatë, por jo edhe afatshkurtër. Ne e kemi pa si mundësi që me e pas investitorin për interes publik sepse krijohen edhe vende të reja të punës dhe pjesa e produkteve që prodhohen aty kanë me qenë të veçanta për nivel vendi dhe ju kisha lutur që çështjen e pronave dhe interesit publik patjetër që shkon përmes Kuvendit e nuk kemi nevojë as me e gjykuar që mundet me ndikuar realisht negativisht te pjesa e investitorëve. Investitori është Pharmabel ka një kontratë njëvjeçare të dhënies në shfrytëzim për pastrim të terrenit dhe ka vendosur një bazament që ka me i vendosur pajisjet, ne i kemi filluar procedurat e negociimit. Unë mendoj që një investim jo të tillë po të gjitha që ndikojnë në zhvillim ekonomik duhet të përkrahën pa mëdyshje.

Niman Beqiraj, LVV- unë e kuptoj si kryetari ka të drejtë me bërë negociim por në këtë rast pyetja ime është ajo u jep për një vjet, ti po thua si është dashur të ishte, por kjo nuk e arsyeton, ti me e sjellë këdo prej investitorëve duke shkel ligjin, ti ja ke dhënë për një vit, çka nëse vjen dikush me negociim edhe e jep një ofertë shumë më të mirë se çfare e ka dhënë ai, a ka mundësi prej drejtorit të Inspektionit ose të Urbanizimit me e ditur a ka leje për atë themel që e ka qit pasi është vetëm për një vit.

Nënkryetari i Komunës, z. Genc Ademaj- po flasim për ndërtimin e një fabrike Niman. Ta dhashë një sqarim shumë të mirë. Po flasim për një investim pesë-gjashhtë million euro. Kërkesat tua sa e kanë marrë në shfrytëzim janë banale para opinionit.

Ali Nimanaj, PDK- përshëndet të gjithë të pranishmit! Dua të flas për dy akte që janë kthyer në rishqyrtim nga MAPL-ja. Dua të ndalem në këtë pikë për shkak se lidhet me çështjen e pronave, është bërë debat në mbledhjen e kaluar pikërisht çështja e pronave ka qenë ajo që e ka nxitur debatin ku ne si PDK dhe të tjerët që e kanë lëshuar mbledhjen ka qenë pikërisht ajo që kemi kërkuar që kjo pikë e rendit të ditës të hiqet për shkak se është në kundërshtim me ligjin e në rast se ju keni potencuar se është një afat shtesë të shtyhet për mbledhjen e radhës për shkak se materiali ka qenë i pa kompletuar, nuk ka pasur të bëj me politikë sepse pas daljes tonë është folur shumë se po bëjmë politikë në kuptimin e opinionit, mirëpo sot është mirë që atë pjesën ta vazhdojmë të njejtën që me e sqaruar opinionin, qytetarët e Istogut mbi aktet e ligjshmërisë të cilat i ka kthyer ministria. Ministria thotë që vendimi i Kuvendit të komunës së Istogut është në kundërshtim me ligjin mbi Dhënien dhe Këmbimin e pronës publike, dhe duhet të përcaktohen këto thotë ' komuna duhet të publikoj listen e përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës si dhe listen e veçantë të pronave që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin vijues deri me 31 dhjetor, duke arsyetuar interesin publik dhe zhvillimin ekonomik të komunës, e thotë në mënyrë taksative. Nuk ka minister që mundet me e ndryshuar ligjin. Nëse një minister ka marrë vendim me tejkalluar ligjin dhe me e shkel neve nuk na është prezantuar këtu. Dhe mbi bazën e kësaj që është potencuar atë ditë këtu dy pika duhet me u plotësuar e para e lexova data deri me 31 dhjetor dhe e dyta thotë ' lista e pronave të paluajtshme për dhënie në shfrytëzim duhet t'i përmbajë këto të dhëna, të cilat ju i keni dhënë. Thirrëmi në shqyrtimin e ligjshmërisë brenda 30 ditësh. Brenda 30 ditësh normal që e kthen sepse anulimi i atij vendimi është brenda 30 ditësh. Nëse ne e lëmë deri në fund të vitit me e potencuar 31 dhjetor ne kemi mundësi me i përmirësuar këto rekomandime të MAPL-së dhe të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ka qenë mbledhja urgjente, ne sot e morëm materialin, po flasim për konfirmimin e ligjshmërisë. Është potencuar atë ditë që ne kemi dalë me ja pamundësuar kolegëve tanë të respektuar, thotë kuorumi duhet të ekzistoj për të gjitha takimet e Kuvendit të Komunës, dhe në fund thotë Kuvendi i komunës ka miratuar me shumicë votash rendin e ditës për betimin e anëtarëve të rinj, vetëm ta lexojmë saktë çfarë thotë konfirmimi i ligjshmërisë. Nëse atë ditë në mbledhje ishte larguar kjo pikë e rendit të ditës ne kishim me vazhduar dhe kemi pasur edhe shumë pika me i diskutuar që kanë qenë pjesë e asaj mbledhje. Po flas edhe si PDK edhe si jurist, aty ku konstatoj që mundet me u shkel ligjin jam i thirrur me potencuar të drejtën bazuar në ligjin që është në fuqi.

Kryesuesi i Kuvendit, Enver Rugova- në një lloj mënyre atë ditë në mbledhje ju keni dale si bllokues të Kuvendit, këtë më duhet të ta them Ali, politikisht ishte ashtu. E kanë kthyer ligjshmërinë në bazë të kërkesës së dy anëtarëve të Kuvendit dhe tani çdo gjë është në rregull. Nuk ka shkelje ligjore, ju kemi përmbajtur strikt. Fjalën e ka drejtori Agon Dreshaj.

Drejtor i Kadastrit, z. Agon Dreshaj- Ali faleminderit që e konfirmove edhe njëherë atë që e kam thënë unë në mbledhjen e kaluar dhe në fillim të kësaj mbledhje sot. Keni kërkuar të hiqet, sepse në mbledhjen e kaluar Astriti ka thënë të shtyhet, e respektoj të drejtën e propozimit, por keni pasur të drejtë me propozuar që të hiqet por jo të shtyhet. Ministri nuk ka të drejtë me ndryshuar ligjin, nuk është kjo çështja por ajo e zgjatjes së afateve, ligji për Legalizimet a ka përfunduar me 31 dhjetor të vitit të kaluar? Kush e ka zgjat afatin që ende po aplikojnë, me vendim ministri sepse e ka të drejtë ligjore me e zgjat për një vit. Me të njëjtin ligj është aprovuar lista vitin e kaluar, në të njëjtin ligj jemi bazuar dhe është refuzuar këtë vit, si ndodhë kjo? Vazhdon sqarimin.

Ali Nimanaj, PDK- kryesues po e filloj me replikë me ty pastaj me drejtorin. A mund ta lexoj këtë vendim që është kthyer se çka thotë, po thotë 'komuna duhet të publikoj listen e përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës si dhe listen e veçantë të pronave që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin vijues deri me 31 dhjetor, ky akt është i nxjerrë nga MAPL-ja as nga unë as nga ti. Në rast se i keni këto vendimet e ministrit për shtyrje të afatit pse nuk i prezantoni në Kuvend. A doni me e qit në lajthitje Kuvendin? Akti që drejtori po thirret është deri me 31 dhjetor këtë e ka nënshkruar edhe vet ministri. E dyta kryesues, për hir të mbarëvajtjes së punëve dhe mirëkuptimit në Kuvendin komunal, vetëm ta transmetojmë atë që e themi tekstualisht e jo me e parafrazuar atë çka ne potencialisht mundemi me e menduar por nuk e themi. Vetëm kemi kërkuar me e hek atë pike e nëse është vendimi me na prezantuar e me shtyer në të kundërtën është e drejtë demokratike kur është diçka ligjore me e përdor të drejtën tënde se fuqi politike me e ndaluar nuk kemi pasur dhe nuk kemi dashur të bëhemi pjesë e atij procesi kaq. Nuk kemi përdor as gjuhë fyese as tonalitet, ju kemi drejtuar Kuvendit për një punë më të mirë.

Nënkryetari i Komunës, z. Genc Ademaj- Ali për hir të debatit sepse u diskutua shumë kisha pasur një kërkesë sepse pronat janë të shenjta dhe interesi publik varet prej këtij veprimi që ne sot jemi duke e diskutuar dhe keni me marrë vendim ju me prezantimin që është bërë nga ekzekutivi, e diskutuam një çështje që është votuar katër-pesë vite radhazi, në mbledhjen e kaluar nuk kam qenë personalisht por e di prej praktikave të mëhershme që edhe në mandatin e vitit 2022 kemi qenë këtu bashkërisht dhe e kemi votuar me 31 mars 2022 listën e përgjithshme dhe të veçantë të pronave, pra nuk ka qenë praktikë e panjohur. Afatin ligjor e kemi zënë, punën e kemi bërë, e kemi prezantuar para jush, nëse

ka pyetje shtesë për ndonjë pronë hajde ta shtjerrim atë, për pjesën teknike përmbajtje dhe të ligjit është Kuvendi me trupin e vet edhe MAPL-ja që prapë e bën monitorimin dhe mbetet përgjegjësi e tyre, unë mendoj që te baza dhe pjesa ligjore jemi në rregull. Po ju lus ta futim në votim, sepse komunës i hapë dyer me sjellë investitorë sepse ka interes për investime të jashtme.

Niman Beqiraj, LVV- kisha kërkuar prej nënkryetarit që me ma dhënë një përgjigje pa hyrë në pjesën politike se a është e rëndësishme se ajo është normale momentin që i jepet dikujt toka, vjen këtu nëse don me e sqaruar atëherë ne e propozojmë. Pyetja është kështu nënkryetar, ai themel që është bërë një javë para zgjedhjeve a ka leje dhe a mundet drejtorja e Inspeksionit ose Urbanizimit me e treguar këtë?

Drejtor i Inspeksionit, z. Dukagjin Hoxhaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Per pyetjen Niman se a ka leje apo jo sipas ligjit të ndërtimit neni 5 paragrafi 1.7 mos gabofsha thotë që edhe për objektet të kategorisë të tillë jepet leja ndërtimore. Për momentin nuk ka çka me jep leje ndërtimore aty se nuk ka objekt. Kanë dalë edhe inspektorët në terren por nuk ka objekt. Është një gurthemel, është në fazën përgatitore për lejen ndërtimore dhe kushtet. Është në procedurë të pajisjes për momentin.

Niman Beqiraj, LVV- edhe një pyetje, është në procedurë të pajisjes të lejes, a i bie që e ka apo nuk e ka lejen.

Drejtor i Inspeksionit, z. Dukagjin Hoxhaj- a po pyet për guthemelin a ka leje apo për objekt a kom mi jep leje a jo vetëm të jemi të qartë.

Niman Beqiraj, LVV- a ka pasur leje me e filluar atë gurthemel edhe nëse ka si ja keni dhënë?

Valbone Demaj, LDK- përshëndet të gjithë të pranishmit! Pata diçka në lidhje me MAPL-në, javën e kaluar ishim në një trajnim katër kolegë i kemi këtu të pranishëm dhe një trajner na tha që MAPL-ja i këshillon komunat dhe jo që merr vendime sepse tha në të shumtën e rasteve ka kthyer vendime që nuk ju ka përshtatur komunës, komuna ka vazhduar dhe i ka dërguar nëpër gjykata dhe ka fituar komuna. Dhe për të qenë më të qartë, MAPL-ja është organ këshillues dhe jo vendimarrës.

Arben Kabashi, PDK- po i kthej përgjigje Valbones, asnjë vendim nuk i kthehet Kuvendit pa nënshkrimin e ministrit. Dhe një pyetje drejtorit, Dukagjinit, kjo i bie që ku të më teket një prone publike me ja qit themelin dhe ti mos me ardh me ma ndaluar mua.

Kryesuesi i Kuvendit, Enver Rugova- po më duket që debati u konsumua, po e hedh në votim, kush është të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Kush është për?

Konstatojmë që nga 23 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 14 vota për 8 kundër dhe 1 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrje, dhe kontributin tuaj në këtë mbledhje. Shpall mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:20.

**Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj**

**Kryesues i Kuvendit
z. Enver Rugova**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT
MINISTRIA E FINANCAVE-MINISTARSTVO ZA FINANSIJE-MINISTRY OF FINANCE

Njësi Org. Org. Jedinica Org. Unit: 06/4/40 Nr. Prot. Prot. No.: 987/2026

Nr. i faqeve Broj stranica No. pages: 15, 05, 26

PRISHTINË/PRISTINA / PRISHTINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Financav / Ministarstvo za Finansije/ Ministry of Finance

Zyra e Ministrit / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister

DATË/A:	15.05.2026
PËR/ZA/TO:	Ministrat, Kryetarët e Komunave, Sekretarët e Përgjithshëm, Kryeshefat e Agjencive, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zyrtarët Kryesor Financiar
NGA/OD/FROM:	Hekuran Murati, Ministër i Financave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja Buxhetore 2027/01

Të nderuar,

Me lejon t'ju shpreh falënderimin tim për kontributin tuaj të çmuar në hartimin e projeksioneve buxhetore për periudhën 2027–2029, të cilat përbëjnë bazën për përgatitjen e buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2027.

Në vijim, ju përcjellim Qarkoren Buxhetore 2027/01, e cila përmban kufijtë fillestarë buxhetorë për secilën Organizatë Buxhetore në nivel qendror, si dhe kufijtë buxhetorë për nivelin komunal për periudhën 2027–2029.

Ministria e Financave mbetet në dispozicionin tuaj për të ofruar mbështetjen e nevojshme gjatë procesit të hartimit të Projektligjit për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2027.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin.

Me respekt!

Hekuran Murati
Ministër i Financave



Qarkorja Buxhetore 2027/01

1. Qëllimi

Në përputhje me nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ministri për Financa është i autorizuar dhe përgjegjës të lëshojë qarkore buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore, me qëllim të ofrimit të udhëzimeve për përgatitjen e Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Në mbështetje të kësaj dispozite ligjore, Ministri lëshon Qarkoren Buxhetore 2027/01, e cila përmban udhëzimet e para për hartimin e buxhetit për vitin 2027, si dhe vlerësimet për vitet 2028 dhe 2029. Kjo qarkore përfshin gjithashtu kalendarin kohor indikativ për procesin buxhetor dhe kufijtë fillestarë buxhetorë për vitin 2027, përkatësisht vlerësimet për vitet 2028-2029 për secilën organizatë buxhetore.

Në rast nevoje, pas kësaj qarkoreje do të lëshohen edhe qarkore të tjera plotësuese deri në finalizimin e plotë të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2027 dhe vlerësimeve për vitet pasuese.

2. Konteksti për përgatitjen e buxhetit për 2027-2029

Planifikimi i buxhetit për vitin 2027 mbështet në prioritetet qeveritare dhe kornizën makro-fiskale. Qeveria është e përkushtuar që duke ruajtur stabilitetin fiskal të përkrah kërkesat e organizatave buxhetore, në përputhje me orientimet sektoriale buxhetore dhe prioritetet e përcaktuara.

Objektivat strategjike të Qeverisë janë përcaktuar përmes Programit të Qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, dhe strategjive sektoriale, si dhe nëpërmjet dokumenteve që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian, si Programi për Reforma në Ekonomi 2026-2028 dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Prioritetet e Qeverisë për periudhën trevjeçare të ardhshme përqendrohen në ri-orientimin e ekonomisë drejt prodhimit dhe eksportit, rritjen e punësimit, dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, që mbrojnë mjedisin dhe sigurojnë ruajtjen e tij për brezat e ardhshëm. Po ashtu, një tjetër prioritet është orientimi drejt transformimit digjital.

Projeksionet fiskale kanë përcaktuar burimet e mundshme të financimit që Qeveria mund të disponojë për shpenzime në vitin 2027, si dhe vlerësimet për vitet 2028-2029. Çdo tejkallim i kufijve të shpenzimeve të përcaktuara në këtë qarkore do të bëjë të detyrueshëm ndryshimin e burimeve të financimit, përfshirë mundësinë e rritjes së burimeve të financimit dhe/ose ndryshimin e politikave tatimore për të siguruar të hyra shtesë.

Gjatë procesit të hartimit të buxhetit, duhet të merren parasysh zotimet tona ndaj institucioneve financiare ndërkombëtare. Në këtë kuadër, Qarkorja Buxhetore 2027/01 është hartuar në përputhje me obligimet e deritanishme nga marrëveshjet financiare ekzistuese dhe ato në proces negociate, duke pasqyruar përkushtimet për politikën fiskale në përputhje me kërkesat e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

3. Parashikimet për implementimin e buxhetit 2027

Para dorëzimit të kërkesave buxhetore për vitin 2027, organizatat buxhetore duhet t'i paraqesin Ministrisë së Financave parashikimin e realizimit të buxhetit për vitin 2026 deri në fund të vitit, në nivel të programeve, nënprogrameve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve individuale. Gjithashtu, organizatat buxhetore obligohen të identifikojnë dhe të informojnë Ministrinë për çdo nënshpenzim të mundshëm në buxhetin aktual, si dhe për pritjet lidhur me mbishpenzimet, para dorëzimit të kërkesave buxhetore për vitin 2027 dhe vlerësimeve për vitet 2028–2029.

4. Kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit për 2027-2029

Procesi buxhetor për vitet 2027-2029 ka për qëllim të lidh planet dhe politikat buxhetore me prioritetet e Qeverisë. Në nivel sektorial, kjo është realizuar duke prioritetizuar sektorët buxhetorë sipas projeksioneve për periudhën 2027-2029. Përmes kësaj qarkoreje, kërkohet që organizatat buxhetore të konkretizojnë kërkesat e paraqitura, duke detajuar përgatitjen e buxhetit në nivelin e programeve, nën-programeve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve specifike.

Kërkesat për shpenzime të reja duhet të paraqiten vetëm nëse ka hapësirë fiskale të lirë dhe nëse ato janë përfshirë në projeksionet për periudhën 2027-2029. Gjatë procesit buxhetor, Ministria e Financave duhet të sigurohet që totali i shpenzimeve për të gjitha organizatat brenda një sektori të mos e kalojë shumën e parashikuar në projeksionet për sektorin për vitet 2027-2029.

Organizatat buxhetore duhet të kenë parasysh që gjatë përgatitjes së kërkesave të tyre, t'u japin prioritet:

- Projekteve që kontribuojnë në realizimin e prioriteteve të Qeverisë dhe dokumenteve strategjike;
- Projekteve që janë në vazhdimësi nga vitet e kaluar dhe kanë obligime kontraktuale, përfshirë edhe ato të shpronësimit të lidhura me këto projekte;
- Zotimeve të Qeverisë për Planin e Veprimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe për programin Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA);
- Legjislacionit të ri ose ndryshimit dhe plotësimit të legjislacionit ekzistues;
- Obligimeve për financim të jashtëm për projekte individuale, të cilat duhet të përfshihen brenda ndarjeve buxhetore dhe
- Aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me Agjendën e reformave në kuadër të Planit të Rritjes.

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël;
- Përmirësimi i qasjes së buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës;
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar në planifikimin e projekteve kapitale;
- Prezantimi në formë tabelare i burimeve të financimit dhe strukturës së shpenzimeve sipas kategorive për vitin 2027, si dhe projeksioneve për vitet 2028–2029.

Gjatë procesit buxhetor, organizatat buxhetore (OB) në nivel qendror dhe lokal duhet t'i kushtojnë vëmendje të shtuar zbatimit të çështjeve në vijim:

1.5. Anëtarësimi në bibliotekë për të gjithë të tjerët;	3
1.6. Dhënia në shfrytëzim e hapësirave rreth shtëpisë së kulturës m ² mujore;	1
1.7. Dhënia në shfrytëzim e zyrave në Shtëpinë e Kulturës m ² mujore;	0.70
2. Shfrytëzimi i terreneve dhe hapësirave rekreative-sportive (me pak se një vit)	
2.1. Dhënia në shfrytëzim e palestrës sportive - mujore për klubet e licencuara të Komunës së Istogut;	0
2.2. Dhënia në shfrytëzim e hapësirave rreth palestrës së sportive m ² mujore për klubet e licencuara të Komunës së Istogut	0
2.3. Dhënia në shfrytëzim e stadiumit të qytetit - mujore për klubet e licencuara të Komunës së Istogut;	0
2.4. Dhënia në shfrytëzim e palestrës së sportive - për një orë;	15
2.5. Dhënia në shfrytëzim e hapësirave rreth sallës së sportive m ² mujore;	0.50

2.6. Dhënia në shfrytëzim e stadiumit te qytetit - për një orë;	30
2.7. Dhënia në shfrytëzim të fushës ndihmëse të futbollit – për dy orë	25

Neni 9
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Emërtimi dhe përshkrimi i dokumenteve të shërbimit	Shuma €
1. Lëshuarja e vërtetimeve dhe shkresave të ndryshme nga Drejtoria	
1.1. Vërtetim për arsyetimin e shpenzimeve të varrimit për jashtë vendit;	3
1.2. Vërtetimi që nuk kanë sigurim shëndetësor në Kosovë;	3
1.3. Leje për Ekshumimin e Kufomave;	50
1. Çmimorja e bashkë pagesave për shërbime shëndetësore në nivelin parësorë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.03/2024 Bashkë Pagesat për Shërbimet Shëndetësore	
1.2. Ekzaminimi mjekësor në AMF, QMF ose në QKMF, pa analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë;	1
2.2. Vizita e përsëritur mjekësore që ka për qëllim shqyrtimin e rezultateve të analizave laboratorike dhe të ekzaminimeve plotësuese, të kërkuara nga mjeku i institucionit të njëjtë shëndetësor (në periudhën brenda dy javëve);	0
2.3. Vizitat në QMF ose në QKMF e cila realizohet brenda 24 orëve prej momentit të referimit nga Punkti shëndetësor;	0
2.4. Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF me udhëzim të Mjekut të Familjes;	2
2.5. Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF pa udhëzim të Mjekut të Familjes;	5
2.6. Vizita në shtëpi në thirrjet për kujdes emergjent, Nëse pas vizitës mjeku e konstaton se ra nuk ka qenë rast urgjent-emergjent ;	6
2.7. Me përjashtim të rasteve emergjente, qytetarët që kërkojnë shërbime në institucionet e KPSH jashtë zonës së banimit të caktuar nga institucionet përkatëse;	5
2.8. Ultrazëri standard i realizuar nga specialisti i radiologjisë;	2
2.9. Radiografia;	2
2.10. Testet laboratorike në situatat e gjendjeve urgjente(psh. Leukocitet, glikemia, urina etj.)	0
2.11. Analizat laboratorike-vetëm hemogrami (SE, eritrocitet, leukocitet, hematocrit, hemoglobin, trombocite, koha e koagulimit, koha e gjakderdhjes) dhe urina (analiza e përgjithshme, gjaku me lakmues, pamja ngjyra, era, pesha specifike, pH, proteinet ne urine, ketonet, proteina, ekzaminimi mikroskopik i urines së sedimentuar);	1
2.12. Analizat biokimike (glikemia, urea, kreatinini, AST, ALT, bilirubina direkte, bilirubina totale, holesteroli, trigliceridet)	1
2.13. Analizat laboratorike-hemogrami dhe biokimike (SE, eritrocitet, leukocitet, hematocrit, hemoglobin, trombocite, koha e koagulimit, koha e gjakderdhjes) dhe urina, si dhe analizat biokimike (glikemia, urea, kreatinini, AST, ALT, bilirubina direkte, bilirubina totale, holesteroli, trigliceridet)	3
2.14. Analizat laboratorike T3, T4, TSH ;	1
2.15. Analizat ASTO, Faktori rheumatoid;	1
2.16. Homoglobina e glukogjenizuar;	1
2.17. Fraksionet e yndyrave;	1
2.18. Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore;	1

2.19. Elektrolitët;	1
2.20. Audiograma;	1
2.21. Shpërlarja e veshit;	1
2.22. Përpunimi i plagëve me qepjes dhe pastrimi deri në shërim të plagës (vetëm me vizitën parë);	1
2.23. Trajtimi ditor me injeksione dhe infuzione në institucionin shëndetësor;	1
2.24. Inhalimi ditor në institucionin shëndetësor;	0.50
2.25. Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore;	5
2.26. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive, etj.-për një orë;	25
3. Çmimorja e pagesave për shërbime stomatologjike të nivelit parësor-QKMF dhe QMF	
3.1. Vizita e parë stomatologjike;	1
3.2. Vizita kontrolluese;	0
3.3. RTG i dhëmbit;	1
3.4. Ndalja e gjakderdhjes (urgjencë);	0
3.5. Ndalja e gjakderdhjes postekstraktive (urgjencë);	0
3.6. Mbushje e përhershme me amalgamë;	3
3.7. Mbushje e përhershme me kompozitë;	4
3.8. Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme(amalgamë apo kompozitë);	4
3.9. Shërimi i alveolitit me seanca;	1
3.10. Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	5
3.11. Extirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	5
3.12. Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	5
3.13. Extirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	5
3.14. Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë);	5
3.15. Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme;	5
3.16. Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës;	1
3.17. Fluorizmi i dhëmbëve sipas seancave;	1
3.18. Vulosja e fisurave;	1
3.19. Mënjanimi i depozitimeve të buta;	1
3.20. Mënjanimi i depozitimeve të forta (heqja e gurëzve të dhëmbëve me ultratingull);	3
3.21. Kiretazha e xhepave parodontal (një dhëmbi);	1
3.22. Nxjerrja e dhëmbit;	1
3.23. Incizioni intra dhe extra oral;	1
3.24. Heqja e kurorës me anë të prerjes;	1
3.25. Drenazha e dhëmbit;	1
3.26. Riparimi i protezës (ngjitja)	1
3.27. Heqja e penjve	0
1.3. Ekzaminimi mjekësor në AMF, QMF dhe QKMF, pa analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë; 50	1
2.2. Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF me udhëzim të Mjekut të familjes;	2
2.3. Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF pa udhëzim të Mjekut Familjar;	5

2.4. Ekzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente;	6
2.5. Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatore publike;	0.30
2.6. Ultrazëri standard;	2
2.7. Radiografia;	2
2.8. EKG;	0.50
2.9. Analiza laboratorike-vetëm hemogrami dhe urina;	1
2.10. Analiza laboratorike komplet;	3
2.11. Caktimi i sheqerit në gjak në gleukometër, sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore;	1
2.12. Audiograma;	1
2.13. Shpëlarja e veshit;	1
2.14. Dhënia e injeksionit intramuskular në shtëpi, përpos në raste emergjente;	1
2.15. Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në raste emergjente;	1
2.16. Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës; vetëm në vizitën e parë;	3
2.17. Trajtimi ditor me infuzione në institucione shëndetësore;	1
2.18. Certifikata Shëndetësore (CM0101) për regjistrim të fëmijëve në çerdhe dhe kopshte	0
2.19. Certifikata Shëndetësore (CM0102) për regjistrim në shkolla fillore, të mesme të larta, fakultete dhe nivele tjera shkollim;	0
2.20. Certifikata Shëndetësore (CM0201) për punësim;	15
2.21. Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore;	5
2.22. Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore për shtetasit e huaj;	25
2.23. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive për 1 orë;	25
3. Çmimorja e pagesave për shërbime stomatologjike të nivelit parësor-QKMF dhe QMF	
3.1. Vizita e parë stomatologjike;	1
3.2. RTG i dhëmbit;	1.5
3.3. Mbushja e përhershme me amalgamë;	4
3.4. Mbushja e përhershme me kompozitë;	5
3.5. Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	5
3.6. Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	6
3.7. Extirpimivital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	6
3.8. Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	6
3.9. Extirpimimortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	6
3.10. Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	6
3.11. Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme;	6
3.12. Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës;	1
3.13. Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave;	1
3.14. Vulosja e fisuarave;	1
3.15. Mënjanimi i depozitimeve të buta;	1
3.16. Mënjanimi i depozitimeve të forta (heqja e gurësve të dhëmbëve me ultratingull);	3

3.17. Kiretazha e xhepave pararental (një dhembë);	1
3.18. Nxjerrja e dhëmbit;	1.5
3.19. Incizioni infra dhe ekstra oral;	1.5
3.20. Heqja e kurorës me anë të prerjes;	1
3.21. Riparimi i protezës.	1.5
4. Shfrytëzimi i Autoambulancës me kërkesë të klientit pa referim të mjekut e që nuk janë raste Emergjente	
4.1. Relacioni Istog-Pejë;	10
4.2. Relacioni Istog-Prishtinë;	30
4.3. Relacioni Istog-Tiranë;	100
4.4. Relacioni Istog-Shkup;	100
5. Çmimet e Pagesave për Shërbime në Qendrën Sociale	
5.1. Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e Veprimit e vlefshme për 1 vit;	2
5.2. Konstatimi që nuk ka obligime ligjore (Alimentacion) ndaj personave përgjegjës ligjor për heqje të nënshtetësisë të Republikës së Kosovës;	10
5.3. Konstatimi që posedon mjete material për ekzistencë (për marrje të nënshtetësisë të Republikës së Kosovës);	10
5.4. Pëlqim për bashkim familjar në botën e jashtme;	10
5.5. Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e veprimit për armëmbajtje;	20
5.6. Vërtetim që nuk është shfrytëzues i ndihmës sociale;	5

Neni 10
Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

Shërbimet/aktivitetet	Shuma €
1. Lejet për ndërhyrje në infrastruktura dhe hapësira tjetër publike	
1.1. Leja për prerjen e asfaltit në rrugë dhe trotuare për 1m ² ;	50
1.2. Leja për prerjen e rrugëve dhe trotuareve të pa asfaltuara, parqeve, kabëzave të betonit, beton, për 1m ² ;	25
2. Shërbime tjera	
2.1. Leja për vendosjen e materialit ndërtimor, drujve, thëngjilli etj. në hapësirat publike për 24 orë.	10
3. Leje për bllokim të rrugës (shiritit rrugor-trotuarit)	
3.1. Zona urbane-12 orë;	20
3.2. Zona urbane-24 orë;	25
3.3. Leja për ndalje (ngarkim shkarkim) të mallrave në rrugë dhe trotuar, në ato vende ku nuk pengohet komunikacioni, për 1 ditë;	10
3.4. Leja për ndalje (ngarkim shkarkim) të mallrave në rrugë dhe trotuar, në ato vende ku nuk pengohet komunikacioni, për 1 muaj;	20

3.5. Leja për ndalje (ngarkim shkarkim) të mallrave në rrugë dhe trotuar, në ato vende ku nuk pengohet komunikacioni për 1 vit;	80
3.6. Leje për auto taxi 4+1 ulëse për 1 vit;	50
3.7. Leje për kombi bus 8+1 ulëse (Leje e veçanet për transportin e nxënësve të mësimit fillor) për 1 vit;	60
3.8. Ndërrimi i Lejes për auto-taxi (nënkuptohet kur nga pronari ndërrohet automjeti para skadimit të Lejes që është pajisur me parë);	10
3.9. Vërtetimi i rendit të udhëtimit për linjën e rregullt të udhëtareve dhe për transport të veçanet, Operatori transportues paguan taksën për një vit (për një relacion-nisje të caktuar);	25
4. Lejet për automjetet e renda transportuese me peshë prej 3.5-7.5 ton, të cilat kanë nevojë për të qarkulluar në rrugë (qendrës së qytetit) ku me shenjë të komunikacionit e kanë të ndaluar.	
4.1. Leje e lëshuar për 1 deri në 3 ditë;	10
4.2. Leje e lëshuar për 1 deri në 15 ditë;	20
4.3. Leje e lëshuar për një muaj;	30
4.4. Leje e lëshuar vjetore të cilat rrugë shfrytëzohen herë pas here;	80
5. Lejet për automjetet e renda transportuese me peshë mbi 7.5 ton, të cilat kanë nevojë për të qarkulluar në rrugë (qendrës së qytetit) ku me shenjë të komunikacionit e kanë të ndaluar;	
5.1. Leje e lëshuar për 1 deri në 3 ditë;	15
5.2. Leje e lëshuar për 1 deri në 15 ditë;	25
5.3. Leje e lëshuar për një muaj;	40
5.4. Leje e lëshuar vjetore të cilat rrugë shfrytëzohen herë pas here;	100
6. Parkingje publike shiritore	
6.1. Në parkingjet publike me shirita të ndarë në rrugë, trotuar-tarifa mujore për persona fizik;	30
6.2. Në parkingjet publike me shirita të ndarë në rrugë, trotuar-tarifa mujore për persona juridik;	50
6.3. Në parkingjet publike me shirita të ndarë në rrugë, trotuare-tarifa vjetore për persona fizik dhe juridik;	420
7. Pëlqim për plotësimin e kushteve teknike për rrugë lokale dhe zona urbane	
7.1. Lëshimi i pëlqimit për plotësimin e kushteve teknike për çdo kyçje-qasje në infrastrukturën rrugore, pa shirita qarkullues përcjellës;	10
7.2. Vërtetime të ndryshme (Certifikata mbi kryerjen-moskryerjen e shërbimit ushtarak);	5
7.3. Lëshimi i pëlqimit për plotësimin e kushteve teknike për çdo kyçje-qasje në infrastrukturën rrugore, me shirita qarkullues përcjellës;	40

Neni 11
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

1. Emërtimi dhe përshkrimi i dokumenteve	Shuma në €
1.2. Vërtetim për veprimtari bujqësore;	5.0
1.3. Plotsim ndryshimi i aplikimit për subvencione	5.0
1.4. Çmimi fillestar për dhënie në shfrytëzim të tokës bujqësore, përmes ankandit klasa 1, 2, 3,4	0.008 €/m ²

1.5.Çmimi fillestar për dhënie në shfrytëzim të tokës bujqësore, përmes ankandit klasi 5,6	0.007€/m ²
1.6.Çmimi fillestar për dhënie në shfrytëzim të tokës bujqësore, përmes ankandit klasi 7, 8	0.006€/m ²
2.Taksë për shërbimet profesionale për prerje të pyjeve private	
2.1.Dru zjarri për m ³ në shumë prej:	1.50 €
2.2.Dru zjarri mbi 7 m ³ në shumë prej :	2.00 €
2.3.Dru zjarri për m ³ në shumën prej:	3.00 €
3.Taksa për shfrytëzimin e kullosave NB/Kokë	
3.1.Gjedhët mbi një vjet 1	1.20 €
3.2.Viçat 0.45	0.54 €
3.3.Delet 0.18	0.22 €
3.4.Qengjat 0.1	0.12 €
3.5.Kuajtë dhe gomarët 1	1.20 €
3.6.Dosat 0.3	0.60 €
3.7.Derrat 0.3	0.36 €
3.8.Rosat 0.014	0.02 €

Neni 12
Drejtoria e Inspeksionit

1. Shërbimet/aktivitetet	Shuma në €
1.2. Kontrolla veterinare e therjes së kafshëve në territorin e komunës së Istogut	5.0 €
1.3 Kontrolla veterinare e therjes së kafshëve në thertoret e institucioneve publike në territorin e komunës së Istogut.	0.0 €

Neni 13
Gjobat

1. Sipas nenit 63 të Ligjit për Gjendjen Civile me Nr. 04/L-003 të vitit 2011, për këtë gjobitet personi për këto Shkelje:
 - 1.1.prej njëzet(20) deri pesëdhjetë (50) euro ku nuk paraqet lindjen e fëmijës në afatin e paraparë me ligj;
 - 1.2.prej pesëdhjetë (50) deri njëqind (100) Euro kur nuk e lajmëron vdekjen në afatin e caktuar sipas këtij ligji;
 - 1.3. prej njëzet(20) deri pesëdhjetë (50) Euro kush kryen varrimin pa leje;
2. Gjobat e shqiptuara për kundërvajtje në trafik i takojnë Komunës. Alokimi i mjeteve të arkëtuara bëhet sipas dispozitave të rregullave të thesarit. Mjetet e arkëtuara mund të jenë si rrjedhojë e arkëtimit nga dënimet mandatore, përmes Policisë së Kosovës dhe vendimeve përfundimtare të Gjykatës Themelore Pejë-Dega në Istog.
3. Për mospagimin e taksave dhe ngarkesave të përcaktuara në këtë rregullore, në afatin të cilin e përcakton organi zyrtar përkatës, për të cilat ka faturuar do të inicohet procedura përmbarrimore.
4. Për gjobat mandatore zbatohen Ligjet – Udhëzimet administrative dhe rregulloret komunale në fuqi.
5. Për mbrojtjen e mjedisit zbatohen Ligji i Mbeturinave Nr. 08/L-071 në kuadër të të cilit janë të përfshira gjobat mandatore.

6. Për të gjitha kundërvajtjet që shkaktohen nga personat fizik apo juridik, sanksionet janë te parapara sipas Ligjit për Kundërvajtje Nr.05/L-087, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr/33-2016).

Neni 14

Afati

1. Afati për pagesën e të gjitha taksave, ngarkesa dhe gjobave të shqiptuara sipas kësaj Rregullore është 15 (ditë) .

Neni 15

Mbikëqyrja dhe Zbatimi

Kryetari i Komunës përmes Drejtorive komunale, është përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 16

Lirimi nga pagesa e taksave

1. Bazuar në nën paragrafin 1.8 të paragrafit 1 të nenit 8 dhe nën paragrafin 1.13 të paragrafit 1 të nenit 9 të Ligjit Nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Viktimave Civile dhe familjeve të tyre, nga taksat administrative komunale lirohen: familjet e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së dhe Invalidët e UÇK-së.

2. Nga pagesa e taksave për kryerjen e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë ,janë të liruar nga të gjitha taksat dhe ngarkesat e gjendjes civile nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe Vërtetimeve për tatimin në pronë, lirohen: familjet e viktimave civile të luftës, veteran të luftës dhe familjet e tyre, pjesëtarë të Policisë, pensionistët, shfrytëzuesit e ndihmës sociale, personave me aftësi të kufizuara dhe studentët (të gjitha ato kategori që parashihen me legjislacionin në fuqi) Lirimi i pjesëtareve të njësisë së Zjarrëfiksëve nga shërbimet e shëndetit primar në QKMF dhe AMF,

3. Personat e verbër lirohen nga pagesa e të gjitha taksave komunale që i parasheh kjo Rregullore, bazuar në nenin 6 të Ligjit për personat e verbër Nr.04/L-092 të vitit 2011.

4. Kategoritë e cekura në paragrafin 1 të këtij neni, nuk lirohen nga dënimi me gjobë sipas nenit 63 të Ligjit për Gjendjen Civile me Nr. 04/L-003 të vitit 2011.

5. Nga pagesa e taksës për parashtrimin e kërkesave të përcaktuara me nenin 2, paragrafi 5 dhe nën paragrafin 5.1 të kësaj rregulloreje, lirohen të gjitha kategoritë e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, përfaqësuesit e komuniteteve të cilët parashtrajnë kërkesë në interes të komunitetit, të gjithë ata që parashtrajnë kërkesë për ndihmë shëndetësore, për ndihmë me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, ndihma dhe vërtetimet për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore dhe të tjera, si dhe kërkesat për ndihma tjera.

6. Nga pagesa e taksës të përcaktuar me nenin 8, paragrafi 1 dhe nën paragrafin 1.1.,1.2.,1.3.,1.6. dhe 1.7., lirohen personat fizik dhe juridik për organizimin e koncerteve për qëllime humanitare dhe OJQ-të jofitimprurëse.

7.Të gjithë shfrytëzuesit e Mamografit në QKMF lirohen nga bashkë pagesa-participimi.

8. Personat të cilët u përkasin kategorive të lartcekura janë të obliguar që të sjellin dëshmi përkatëse për tu liruar nga pagesa.

9. Nga pagesa e taksave sipas nenit 3 paragrafi 5 i kësaj Rregulloreje lirohen OJQ dhe organizatat humanitare.

10. Lirimi nga pagesa e taksës dhe tarifës sipas udhëzimit administrativ Nr. 02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës, si dhe sipas plotësimit ndryshimit të udhëzimit administrativ Nr. 05/2022.

11. Lirimi nga taksa për legalizim për ndërtime pa leje sipas nenit 20, paragrafi 4, nën paragrafi 4.3, dhe paragrafi 11 të Ligjit Nr.06/L-024 Për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, në pronësi të përfituesve të skemës së ndihmës sociale, dhe familjet e cenushme.

Neni 17
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha plotësohet ndryshohet Rregullorja për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha **00 Numër: 101/2025 , e datës 30.05.2025**

Neni 18
Hyrja në fuqi

Rregullorja për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjete) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të saj në faqen zyrtare të Komunës, sipas nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opshtina Istok
Municipality of Istog

001 Numër: /2026

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Data: .05.2026

Rregullore Komunale Nr. /2026

KUVENDI I KOMUNËS

**PLOTËSIM – NDRYSHIMI I RREGULLORES PËR ORARIN E PUNËS
PËR SUBJEKTET AFARISTE, HOTELIERE, **PRODHUESE**, ZEJTARE
DHE SHËRBYESE NË KOMUNËN E ISTOGUT**

Istog- /2026

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 12.1 pika c), dhe nenit 40 paragrafit 40.2 pika a) e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), nenit 40 të Ligjit për Tregtinë e Brendshme të Kosovës Nr. 2004/018, Ligjin Nr. 04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/018 për Tregtinë, Ligjit për Veprimtaritë Hoteliere Turistike të Kosovës Nr. 2004/016 dhe Ligjit për Zejtarinë e Kosovës Nr.2004/44, Ligji Nr.03/L-168 për Turizëm,) dhe neneve 33 paragrafi 1 dhe neni 34 paragrafi 34.2 të Statutit të Komunës së Istogut 01nr.62/2010, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur me: 2026, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR ORARIN E PUNËS PËR SUBJEKTET AFARISTE, HOTELIERE, **PRODHUESE ZEJTARE DHE SHËRBYESE NË KOMUNËN E ISTOGUT**

I. DIZPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Me këtë Rregullore do të përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës për veprimtaritë afariste, hoteliere, zejtare dhe shërbyese të cilat veprojnë apo ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Istogut.

Neni 2 Fushëveprimi

Pronarët e subjekteve afariste që ushtrojnë veprimtaritë tregtare, zejtare, hoteliere dhe shërbyese si: dyqaneve të gjitha llojeve, qendrave tregtare, fabrikave, tregjeve, depove, objekteve shëndetësore, farmacive, hoteleve, moteleve, restoranteve, objekteve sportive dhe të rekreacioneve, pishinave, punëtorive të ndryshme, reparteve prodhuese, sallat e dasmave, luna parqeve, shitësve ambulante, poliklinikave (si gjinekologëve, dentistëve etj, ordinancave, laboratorëve etj., pavarësisht se çka prodhohet qoftë në ambient të hapur apo të mbyllur, dhe të shërbimeve tjera që iu ofrohen qytetarëve janë të obliguar t'u përmbahen orarit të punës, të respektohet pushimi dhe përfundimi i orarit të punës, të përcaktuar decidivisht me këtë Rregullore.

Neni 3 Orari

1. Veprimtaritë afariste të përmendura më lart në pajtim me Nenin 1 të kësaj Rregullore, janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës të përcaktuar me këtë Rregullore.

2. Orari i punës përkufizon kohën në të cilën subjekti afarist ushtron veprimtarinë ekonomike nga momenti i fillimit deri në përfundim të orarit të punës, respektivisht deri në momentin kur shfrytëzuesi i shërbimeve nuk mund të ushtrojë veprimtarinë në objekt të subjektit afarist në përputhje me Ligjin dhe me këtë Rregullore.

3. Orari i punës përcaktohet në bazë të dy periudhave, në atë verore dhe dimërore, në intervale kohore, **me përjashtim të veprimtarisë prodhuese.**

4. Subjekti është i obliguar të theksojë orarin e punës në hyrje apo në vende të dukshme të objektit në të cilin kryhet veprimtaria në përputhje me këtë rregullore, duke saktësuar orarin e punës para dite, pas dite, orarin e pushimit ditor si dhe ditët që nuk punohet.

Neni 4

Orari i punës për veprimtarit tregtare

1. Për periudhën verore, prej 1 Prill deri më 30 Tetor, prej orës 08:00 deri më 24:00 (max).
Për periudhën dimërore, prej 1 Nëntorit deri më 31 Mars, prej orës 08:00 deri më 24:00 (max.). (Pauza rregullohet me vendim të brendshëm- 1 orë)
2. Qendrat tregtare për dy periudha orari i punës do të jetë nga ora 08:00 deri në 24:00.
3. Pronari i subjektit afarist me kërkesë të veçantë mund t'i drejtohet Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim për vazhdimin e orarit gjatë ditëve të punës, në vikend dhe gjatë ditëve festive.

Neni 5

Orari i punës për veprimtarit prodhuese

1. Subjektet afariste që ushtrojnë veprimtari prodhuese në territorin e Komunës së Istogut mund të zhvillojnë aktivitetin e tyre me orar të zgjatur të punës, përfshirë organizimin e punës 24 (njëzet e katër) orë, sipas nevojave të procesit të prodhimit.
2. Orët e punës ndërmjet orës 22:00 dhe 6:00 numërohen si punë nate.
3. Pushimet gjatë orarit të punës rregullohen me akt të brendshëm të subjektit afarist në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Orari i punës për veprimtarit zejtare

1. Për periudhën verore, prej 1 Prill deri më 30 Tetor, prej orës 07:00 deri më 24:00 (max), për periudhën dimërore, prej 1 Nëntorit deri më 31 Mars, prej orës 08:00 deri më 21:00 (max.), pauza rregullohet me vendim të brendshëm- 1 orë.
2. Pronari i subjektit afarist me kërkesë të veçantë mund t'i drejtohet Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, për vazhdimin e orarit gjatë ditëve, në vikend dhe gjatë ditëve festive për tërë vitin.

Neni 7

Orari i punës për veprimtaritë hoteliere

1. Për periudhën verore prej 1 Prill deri më 30 Shtator, prej orës 07:00 deri më 24:00.
Për periudhën dimërore prej 1 Tetorit deri më 31 Mars prej orës 07:00 deri më 24:00 Pauza rregullohet me vendim të brendshëm 1 orë për të dy periudhat njëjtë.

2. Hotelet dhe motelet mund të punojnë pandërprerë vetëm me shërbime të fjetjes, mirëpo duke kufizuar të gjitha shërbimet tjera (restorant, bar, etj) pas orarit të caktuar nga 07:00-24:00
3. Në rast se punojnë jashtë këtij orari nëpër bare dhe restorante, duhet ta kenë lejen e posaçme vetëm ditëve të fundjavës, e cila leje lëshohet në pajtim me nenin 16 të kësaj rregulloreje.

Neni 8

Orari i punës për kafene dhe lokale tjera të ngjashme

1. Për kafeteritë dhe lokalet tjera të ngjashme që përpos shërbimeve që ju ofrojnë klientëve me pije dhe ushqim njëherë kanë edhe muzikë të gjallë apo me mjete emetuese të muzikës, orari i punës do të jetë për periudhën verore nga ora 07:00 deri më 1:00 dhe për periudhën dimërore nga ora 07:00 deri më 24:00.
2. Zgjatja e orarit të punës për kafitëri dhe lokalet tjera të ngjashme, bëhet vetën për raste të jashtëzakonshëm apo ndonjë manifestime apo ahengje familjare, vetëm për tri ditë brenda vitit kalendarik prej orës 24 deri në orën 02.
3. Për zgjatjen e orarit të punës sipas paragrafit 2 të këtij neni duhet të parashtrohet kërkesë në Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim në pajtim me nenin 17 të kësaj Rregulloreje.
4. Orari i punës nëpër kafe, bare, disko klube, do të jetë për periudhën verore nga ora 07:00 deri më 1:00 dhe për periudhën dimërore nga ora 07:00 deri më 24:00.
5. Orari i punës për internet-kafe, sony playstacion fillon në orën 08:00 dhe mbaron në orën 24:00.

Neni 9

Orari i punës për zyra juridike dhe sportele të pagesave

1. Orari i punës për avokat, përmbaues privat, sportele të pagesave, zyra juridike dhe ekonomike, zyra të përkthyesve, zyra gjeodezike, këmbimore dhe tjera të ngjashme, dita e diele është ditë pushimi.
2. Orari i punës për të gjitha këto veprimtari të cekura në paragrafi 1 të këtij neni gjatë ditëve të javës prej orës 07:00 deri në orën 16:00, ky orari i njëjtë vlen edhe për ditën e shtunë.

Neni 10

Orari i punës për floktore sallonet e ondulimit

1. Orari i punës nëpër sallonet e ondulimit dhe floktoreve është periudha verore prej 1 Prill e deri më 30 Shtator prej orës 04:00 të mëngjesit deri në orën 21:00.
2. Periudha dimërore nga 1 Tetor deri më 31 Mars prej orës 06:00 deri në orën 20:00

Neni 11
Orari i punës për veprimtaritë sportive

1. Veprimtaritë sportive, stadiumet e improvizuara të futbollit, palestrat sportive, qofshin ato në ambient të hapur apo të mbyllur u lejohej ushtrimi i veprimtarive sportive qofshin në sezonin veror apo dimëror nga ora 08:00 deri në orën 24:00.
2. Të gjitha veprimtaritë e përmendura në paragrafi 1 të këtij neni mund të punojnë me pëlqim paraprak edhe pas orës 24:00, në pajtim me nenin 17 të kësaj Rregulloreje.
3. Përjashtim nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni bëjnë pishinat e hapura për të cilat orari gjatë verës është i kufizuar nga ora 10:00 deri në orën 20:00.

Neni 12
Orari i punës për tregje

1. Orari i punës për tregjet e qytetit caktohet si vijon:
 - 1.1.Periudha verore prej orës 07:20:00
 - 1.2.Periudha dimërore prej orës 08:19:00
2. Tregjeve të gjelbërta të qytetit i mundësohet të operojë çdo ditë të javës duke mos përjashtuar ditë vikendi ose ditët e festave .
3. Tregu i plaçkave mund të operojë çdo ditë të javës dhe ditën e diele mund të punojë deri në ora 13:00
4. Tregu i kafshëve do të punojë ditën e enjte prej orës 05:00 mëngjes deri në 15:00.

Neni 13
Orari i punës për salla të dasmave dhe evente të ndryshme

1. Orari i punës për salla të dasmave gjatë sezonit të verës është deri në ora 01:00.
2. Organizatorët e panairëve, eventeve të ndryshme, ekspozitave, reklamave dhe propagandimi i mallrave e shërbimeve të ndryshme, shitja e mallrave dhe produkteve ushqimore me mjete lëvizëse duhet të kenë caktuar lokacionin dhe njëkohësisht duhet të pajisen me leje për shfrytëzimin e hapësirës publike nga Drejtoritë përkatëse (në leje duhet të shënohet orari i punës).
3. Nëse organizatori nuk pajiset me leje përkatëse, në pajtim me nenin 17. të kësaj Rregulloreje të njëjtit i ndalohet çfarëdo veprimi dhe ndaj tij do të ndërmerren masat e parapara sipas kësaj rregullore dhe ligjeve në fuqi.

Neni 14

Orari i punës për veprimtaritë shëndetësore

1. Orari i punës për Ordinanca specialistike, laboratore, farmaci, klinika dhe poliklinika të cilat operojnë në territorin e Komunës së Istogut është i njëjtë për të dy periudhat, si verore edhe atë dimërore, dhe fillon prej orës 07:00 dhe mbaron në orën 23:00.
2. Veprimtaritë afariste të lartcekura në raste emergjente ditëve të diela dhe gjatë festave shtetërore mund të punojnë edhe jashtë orarit të paraparë në paragrafin 3 të këtij neni.
3. Barnatoret (farmacitë) të cilat operojnë brenda qytetit në afërsi të objekteve kryesore që ofrojnë shërbime shëndetësore duhet të pajisen me leje të veçantë për punë të pandërprerë 24 orëshe pranë Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim duke harmonizuar kujdestaritë prej orës 23:00 deri në orën 07:00 të mëngjesit në përputhje me planin për kujdestari të hartuar në bashkëveprim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale.
4. Orari i kujdestarisë do të publikohet në qendrat mjekësore, barnatore dhe ueb faqen Zyrtare të Komunës, dhe obligohet Shoqata Farmaceutike të përgatis planin mujor të orarit të kujdestarisë.
5. Të gjitha ato barnatore që dëshirojnë të punojnë pas orës 23:00 duhet të posedojnë leje të veçantë për zgjatje të ushtrimit të veprimtarisë.

Neni 15

Orari i punës për dyqane tregtare

1. Orari i punës në dyqanet tregtare të tekstit, dyqanet e këpucëve, dyqanet e pajisjeve teknike shtëpiake “teknikës së bardhë” dhe veprimtarive tjera jo ushqimore do të jetë:
 - 1.1. periudha verore prej orës 07:00-23:00
 - 1.2. periudha dimërore prej orës 08:00-23:00
2. Organizatat e biznesit sipas pikës 1 të këtij neni që veprojnë në periferi të qytetit në ditën e fundjavës (te dielën) mund të punojnë me orar të zgjatur edhe pas orës 12:00 me pëlqim të veçantë brenda vitit kalendarik.

Neni 16

Orari i punës për depo

1. Orari i punës në depot e artikujve ushqimore, depot e materialit ndërtimor dhe në ndërmarrjet që merren me prodhimin e betonit, periudha verore dhe dimërore do të jetë njëjtë.
2. Orari i punës për të gjitha veprimtaritë e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni për periudhën verore dhe dimërore është i njëjtë dhe fillon prej orës 08:00-20:00.
3. Ndërmarrjet ndërtimore në raste të jashtëzakonshme emergjente për shkak të natyrës së punëve me leje të posaçme mund të punojnë me orar të zgjatur deri në orën 23:00.

Neni 17

Orari i punës për ditët e festave

1. Ditët e festave në nivel të Komunës së Istogut janë bazuar në Ligjin për festat shtetërore do të veprohet në përputhje me dispozitat ligjore sipas Ligjit Nr. 03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës.
2. Dita e festës është ditë pushimi, ndërsa subjektet afariste mund të jenë të lira të punojnë në sektorin e shërbimeve me vullnetin e tyre.
3. Organizatat e biznesit mund të zgjasin orarin e punës me rastin e festave, konform Ligjit për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës.

Neni 18

Leja për vazhdimin e orarit të punës

1. Subjektet të cilët kërkojnë leje për vazhdimin e orarit të punës jashtë afatit të caktuar me këtë rregullore, duhet t'i drejtohen me kërkesë organit kompetent, përkatësisht Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim minimum tri ditë para ushtrimit të asaj veprimtarie.
2. Drejtoria e Ekonomi Zhvillim, sipas kërkesës së palës është e obliguar që nga pala të kërkojë edhe dokumentacion shtesë si; certifikatën e regjistrimit të biznesit, pëlqimi nga Inspektorati për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse, pëlqimi i banorëve, ku gjendet lokali, për zgjatje të orarit të punës letërnjoftimin dhe pagesën e taksës së veçantë për leje vazhdim të orarit të punës për subjektin dhe veprimtarinë e caktuar.
3. Inspeksioni është kompetent të del ne vend të ngjarjes për inspektimin e veprimtarisë dhe të konstaton se subjekti po e ushtron veprimtarinë e caktuar jashtë orarit dhe me procesverbal konstaton të meta për mosrespektim (mospërfillje) të orarit të punës, atëherë organi kompetent merr masa ndëshkuese konform kësaj rregullore dhe i merret leja për vazhdimin e orarit të punës.
4. Subjektet të cilat e njëherë kanë shkel lejen për vazhdimin e orarit të punës dhe subjektet të cilat nga Policia e Kosovës njësia në Istog konsiderohen si lokale me precedent prishje të rendit dhe qetësisë publike nuk do të pajisen prapë me leje për zgjatjen e orarit të punës.
5. Subjekti i cili nuk e respekton orarin e punës, sipas lejes së lëshuar në pajtim me këtë nen do t'i merret leja për zgjatje të orarit të punës menjëherë.
- 6.. Për çdo kërkesë të subjekteve afariste për zgjatjen e orarit të punës obligohet Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim që të kërkoj mendimin e Policisë Kosovës njësia në Istog dhe Drejtorisë për Inspeksion.

Neni 19
Taksat për pagesë

1. Taksat për pagesë për punë jashtë orarit të rregullt në Komunën e Istogut llogariten siç vijon me poshtë:
 - 1.1.për 1/një/orë pune të VEPRIMTARIVE tregtare pagesa është 5 €
 - 1.2.për 1/një/orë pune të VEPTIMTARIVE hoteliere pagesa është 10 €
 - 1.3.për 1/një/orë pune të VEPRIMTARIVE zejtare pagesa është 5 €
 - 1.4.për 1/një/orë pune të VEPRIMTARIVE shërbyese pagesa është 10 €
2. Për subjektet afariste të cilët posedojë salla ahengjesh (dasma, syneti, kanagjegj, ditëlindje, matura dhe të tjera të ngjashme), për çdo herë të tejkalimit të orarit të punës, respektivisht pas orës 01:00, janë të obliguar që për çdo aheng të paguajnë 100/njëqind euro/ për ditë në emër të vazhimit të orarit të punës.
3. Restorantet apo sallat e dasmave që posedojnë deri në 200 ulëse paguajnë 50 euro për ditë.
- 4.Restorantet apo sallonet e dasmave që posedojnë deri në 500 ulëse paguajnë 100 euro për ditë.

Neni 20
Dispozitat Ndëshkuese

1. Me dënim me të holla prej 100 deri në 500 (me mundësi ndryshimi sipas propozimeve: do të dënohen për kundërvajtje personat fizik kur vepron në kundërshtim me nenin 4; , me nenin 5; me nenin 6; me nenin 7; me nenin 8; me nenin 9; me nenin 10; me nenin 11; me nenin 12; me paragrafin ,1.3.dhe 4 të nenit 13; me nenin 14 dhe me nenin 15.
2. Me dënim me të holla prej 100 deri në 1000 euro do të dënohet personi juridik ose personi përgjegjës i personit juridik nëse vepron në kundërshtim me nenin 4; , me nenin 5; me nenin 6; me nenin 7; me nenin 8; me nenin 9; me nenin 10; me nenin 11; me nenin 12; me paragrafin ,1.3.dhe 4 të nenit 13; me nenin 14 dhe me nenin 15.

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 21
Mbikëqyrja

- 1.Për zbatimin e kësaj Rregullore do të kujdesen: Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim, Drejtoria për Inspeksion dhe Policia e Kosovës.
- 2.Gjatë kryerjes së inspektimit, inspektorati komunal dhe të tjerët janë të autorizuar që në përputhje me ligjin të veprojnë në përputhshmëri të kësaj rregullore.

Neni 22
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet: Rregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të subjekteve afariste në Komunën e Istogut Nr.6/2011.

Neni 23
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver RUGOVA



Republika e Kosovës

Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Istog

Opština Istok
Municipality of Istog

Plani i punës së KKSB-së për vitin 2026

Duke u bazuar në Planin e punës, palët e përfshira në këtë planë do të shqyrtojnë rreziqet të cilat e kërcënojnë sigurinë e qytetarëve të Komunës së Istogut dhe do parashirojnë rekomandime për Kryetarin e Komunës-Asamblen Komunale për masat parandaluese.

Kategor.	Nr	Rreziqet	Aktivitetet / Aksionet	Periudha e raportimit	Objektiv. e synuara	Kosto
Të drejtat e njeriut	1	Siguria në punë-Sektori i ndertimtarisë: -Pushimet vjetore - Kontratat e punës (permbajtja) - Orari i punës, pagesa shtesë për punën shtesë	Të ftohet për raport inspektorati i punës për të bashkëbiseduar me KKSB-në	Majë	Të identifikohen problemet më serioze të ndërmirren në	Nuk ka
	2	Abuzimi me fëmijë minorë dhe adoleshent Bullizmi në Shkolla	Të ftohet në bashkëbisedim raport përfaqësuesi i qendres për korrektim Përfaqësues të këshillit të nxënësve	Majë		Nuk ka
	3	Mundësi të barabarta për të gjithë -pjerrinat në trotuare, pengohet lëvizja e lirë e qytetarëve në veçanti personat me nevojë të veçanta	Të ftohen për bashkëbisedim nga drejtorja për urbanizëm dhe shërbime publike	Qershor		Nuk ka
Mjedisi Urban	4	Ndotja e ambientit-lumenjve dhe deponit ilegale	Të ftohen në bashkëbisedim nga drejtorja e inspeksionit-“Ambienti”	Shtator	Të kuptohet gjendja aktuale, të identifikohen problemet më serioze të ndërmirren në	të projektohet
	5	Problemet e infrastruktures që ndikojnë në siguri, në zonat urbane të minoriteteve	Të ftohen në bashkëbisedim, Shefi I ZLK-së Drejtorati i	Qershor		të projektohet

			Urbanizmit dhe i Sherbimeve Publike		
Ambienti-Emergjencat	6	Emergjencat dhe Fatkeqësitë natyrore: -A është Istogu i përgatitur për fatkeqsi natyrore -Reagimi ndaj përmytjeve, zjarreve dhe termeteve -Roli i qytetarve në emergjenca dhe -Koordinimi institucional për emergjenca	Drejtorati për Emergjencat, Mbrojtje dhe Shpetim, në koordinim me Drejtorit tjera dhe AME-në	Nëntor	të projektohet
	7	Mbrojtja e pyjeve nga zjarret Mirmbajtja e rrugëve malore	Të ftohen në bashkëbisedim nga Ministria e Bujqësisë, Drejtorati i Bujqësisë Inspektori i Preventives AME	Qershor	Nuk ka
Delikuenca	8	Vjedhjet, vendosja e kamerave të vëzhgimit në zonën e përgjegjësisë, Banjë, Rakosh, Gurakoc, Vrellë dhe Istog,	Raport specifik nga Policia e Kosovës – Stacioni Istog	Shtator	të projektohet kostoja edhe për Vrellë dhe Rakosh
	9	Konsumimi i drogave, tabaqeve dhe alkolit nëpër shkollat-teritorin e Komunës	Raport i Policisë, OJQ “Labirinti” Ftohen Kryetaret e këshillave të nxënësve dhe prindërve	Tetor	të projektohet
	10	Parandalimi i radikalizmit që shpije në terrorizëm	Të ftohen për raportim dhe bashkëbisedim nga njësia e PK-së	Nëntor	të projektohet
Shëndetësia	11	Mbrojtja e konsumatorit Shitja/Blerja e Ushqimit të përditshëm, data të skaduar, prodhim i pa kontrolluar	Të ftohen në bashkëbisedim përfaqësues të AUK-mbrojtja e konsumatorit dhe inspeksioni i Istogut	Tetor	Nuk ka
	12	Gjendja në institucione shëndetsore , ordianca mjekësore -raportet staf-pacient -furnizimi me medikamente etj	Të ftohen në raport udhëheqësit e institucioneve shëndetësore dhe OJQve relevante	Maj Nëntor	Nuk ka

Asambleja Komunale të hartoj Rregulloren për pagesën e anëtarëve të KKSB-së për gjashtë mbledhje të parapara sipas UA.

Rekomandimet nga Kuvendi i Komunes duhet të përfshihen gjatë shqyrtimit të temave, gjegjësisht informacioni kthyes në Këshill nga zyrtarët e Administratës që kanë pranuar detyra konkrete

Aprovuar nga Kuvendi i Komunës me ---.2026

Konfirmohet nga kryesuesi z. Ilir Ferati